



Konferenca e 6-të Ndërvropiane për Brezin e Gjelbër 2012

Brezi i Gjelbër Evropian Kufijtë ndajnë. Natyra bashkon!

Përgjatë "Perdes së Hekurt", e cila ndau kontinentin Evropian në Lindje dhe në Perëndim për gati 40 vjet, është zhvilluar një rrjet i shquar ekologjik dhe një peizazh i gjallë përkujtimor. Pavarësisht mizorisë së saj, zona kufitare i ka dhënë natyrës një pauzë për frymëmarrje për më shumë se 12,500 kilometra, nga Deti Barents në kufirin Ruso-Norvegjez, përgjatë bregut të Baltikut, neper Evropën Qendrore dhe Ballkanit e deri në Detin e Zi. Evropa dikur e ndarë, padashur ka mbështetur ruajtjen dhe zhvillimin e habitateve të vlefshme. Zona kufitare ka shërbyer si një strehë për shumë specie të rrezikuara. Në vitet 1970-të në disa zona të Evropës, ambientalistët përqëndruan vëmendjen në lulëzimin e natyrës dhe kafshëve të egra që ishin duke gjalluar të pashqetësuar. Fillimi i iniciativës së Brezit të Gjelbër të Evropës në vitin 2003 ishte një bashkim i disa nismave të ndryshme rajonale në një iniciativë Evropiane. Sot Brezi i Gjelbër lidh 24 vende dhe është boshti kryesor i një rrjeti ekologjik ndërvropian i cili kontribuon fuqishëm në "Infrastrukturën e Gjelbër" Evropiane. Ai është një simbol për bashkëpunimin ndër-kufitar dhe trashëgimisë së përbashkët Evropiane si natyrore edhe kulturore. Rëndësia e madhe e korridorit ekologjik është e dukshme: rreth 40 parqe kombëtare janë themeluar përgjatë Brezit të Gjelbër Evropian; më shumë se 3,200 zona të mbrojtura natyrore gjenden në brendësi të zonave buferike prej 50 kilometrash nga të dyja anët e Brezit të Gjelbër; brezi kalon nëpër pothuajse të gjitha rajonet bio-gjeografike të Evropës.



Informata në lidhje me Brezin e Gjelbër të Evropës mund të merren nga:



Koordinatorët Rajonalë

Brezi i Gjelbër i Feno-skandinavisë
Baltic Fund for Nature
bfn@bfn.org.ru • www.bfn.org.ru

Norvegji

Bjørn Arne Næss, Miljødirektoratet
bjorn.arne.nass@miljodir.no

Finlandë

Tapio Lindholm, Syke
Tapio.lindholm@ymparisto.fi

Aimo Saano, Metsähallitus
aimo.saano@metsa.fi

Brezi i Gjelbër Balltik

BUND Mecklenburg-Western Pomerania
coordinator@balticgreenbelt.de
www.balticgreenbelt.de

Brezi i Gjelbër i Evropës Qendrore

BUND Project Office Green Belt
greenbelt@bund-naturschutz.de
www.gruenesband.info

Brezi i Gjelbër i Ballkanit

EuroNatur
greenbelt@euronatur.org • www.euronatur.org

Mbështetur nga Agjencia Federale Gjermane për Mbrojtjen e Natyrës / Ministria Federale Gjermane e Mjedisit, Mbrojtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore
www.bfn.de

Botimi i parë, 2013 • Shtypur në letër 100% të riciklueshme

HGS5 gmbh, Fürth/Germany • www.hgs5.net

Z. Brajanoski, J. Flachs, F. Henkel, E. Körner, J. Peltomäki, Macedonian Ecological Society, Museum Mödlareuth/A. Schaffner, H. Schlumprecht, J. Schmiedel, W. Sollberger, Ch. Übl, W. Willner.



Bund für Umwelt und Naturschutz Deutschland



EURONATUR



Grafika
Fotot

Vula



europian
greenbelt



Brezi i Gjelbër Evropian

Kufijtë ndajnë. Natyra bashkon!

www.europeangreenbelt.org

www.europeangreenbelt.org

Ariu i Murrmë, Finlandë - Rusi



Bregdeti i Detit Baltik



Lilium albanicum, Maqedoni - Shqipëri

Brezi i Gjelbër i Evropës përfshin katër rajone organizative: Feno-skandinav, Balltik, Evropën Qendrore dhe atë të Ballkaneve. Drejtimi i përgjithshëm bëhet nga një grup koordinimi me anëtarë nga të gjitha rajonet. Çdo seksion koordinohet nga një koordinator rajonal dhe në çdo shtet Pikat Kombëtare të Kontaktit janë personat përgjegjës.

Brezi i Gjelbër Feno-skandinav – Zinxhiri i rezervave natyrore prej një milion hektarësh

Brezi i Gjelbër Feno-skandinav është një brez territorial që shtrihet në 1,350 kilometra përgjatë kufijve të Norvegjisë, Ruisë dhe Finlandës, nga Deti Barents deri në Detin Balltik. Ky është një Brez i egër, ku pjesa veriore është e dominuar nga likenet, myshqet dhe shkurret e vogla. Pjesa qendrore dhe ajo jugore përbëhet nga pyjet e mëdha halor të tajgës. Këto pyje kanë shërbyer si vend strehimi për gjitarët e mëdhenj si ariu i murrmë dhe dreri. Peisazhi karakterizohet nga ligatinat, moçalet dhe liqenet e panumërta. Ato ofrojnë habitate tv shumta për shumimin e mjellmave (Cygnus cygnus), shpendi kombëtar i Finlandës. Një Memorandum Mirëkuptimi mbi zhvillimin e Brezit të Gjelbër të Feno-skandinavisë është nënshkruar në Shkurt të vitit 2010 nga ministrat e mjedisit të tre vendeve. Kjo marrëveshje lehtëson bashkëpunimin e qëndrueshëm ndër-kufitar nw aspektiet ekologjike, ekonomike dhe sociale.

Brezi i Gjelbër Balltik – Brezi bregdetar

Brezi i Gjelbër Balltik shtrihet përgjatë bregdetit të Detit Balltik. Ky brez karakterizohet nga habitate të ndryshme detare dhe nënujore përgjatë një vije bregdetare mjaft të larmishme me fusha të mëdha dunash, plazhe të gjera, shkëmbinj mbresëlënës dhe



Prëqebulli

lagunat e izoluara, të gjitha këto unike për këtë pjesë të Brezit të Gjelbër së Evropës. Zonat ushtarake kanë shërbyer si rezervat për miliona zogj shtegtarë si dhe për shumë kafshë detare siç janë fokat gri dhe ato me unazë. Fatëkeqësis, që nga vitet 1990 këto brigje janë nën presion të rëndë për shkak të zhvillimit dhe shfrytëzimit. Ruajtja e vlerave natyrore dhe historike e këtij peisazhi tërheqës dhe shumë të kërkuar përbën një sfidë të madhe për Brezin e Gjelbër.

Brezi i Gjelbër i Evropës Qendrore – Peisazhet e ndryshme

Brezi i Gjelbër i Evropës Qendrore përfaqësohet nga një shumëllojshmëri e peisazheve kulturore, pjesërisht të shfrytëzuara intensivisht nga bujqësia. Brezi kalon perms masivin Bohemian me parqet e kombëtare e ndër-kufitare të pyllëzuara më së miri nga Pyjet Bavarez, ndjek rrjedhat e lumenjve gati natyror siç janë Mura dhe Drava. Kalon nëpër kreshtën e gjatë të Maleve Karavanke dhe Alpeve Juliane duke përfunduar në detin Adriatik. Nëpërmjet mbështetjes së shteteve fqinje në nivel rajonale dhe kombëtare si dhe falë financimit nga BE, palët e interesuara përgjatë Brezit të Gjelbër kanë zbatuar dy projekte ndër-kombëtare. Qëllimet kryesore janë mbrojtja e Brezit të Gjelbër si një korridor ekologjik dhe peisazh natyror, zhvillimi i bashkëpunimit ndër-kufitar dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.



Lundërza e Lumit



Kampanja e informimit për Brezit të Gjelbër "Malsch/Malse", Austri - Republika Çeke



Bretkosa e pemëve

Brezi i Gjelbër i Ballkaneve – Brezi malor

Në pjesën më jugore të Brezit të Gjelbër të Evropës gjendet një vatër e nxehtë e biodiversitetit dhe llojeve endemike. E vendosur në vargmalet e Gadishullit Ballkanik, ajo formon një mozaik jashtëzakonisht heterogjen të peisazheve natyrore duke përfshirë ekosistemet e pacënuara alpine, pyjet, stepat si dhe liqenet dhe zonat bregdetare. Krahas peisazheve të jashtëzakonshme kulturore të zhvilluara me një numër specimesh bimore dhe shtazore të rrezikuara. Mbi kodrat e ulta të Sakarit përgjatë kufirit ndërmjet Bullgarisë dhe Turqisë haset shqiponja perandorake. Zonat e largëta kufitare dhe pyjet e mëdha janë vende strehimi për kafshët enigmatike si Rrëqebulli i Ballkanit.

Brezi i Gjelbër i Shqipërisë

Brez i Gjelbër i Shqipërisë konsiderohet i gjithë kufiri shtetëror tokësor prej 720 km. Ky konstatim mbështetet në faktin se Shqipëria në të kaluarën ka qenë një vend i izoluar dhe në zonën kufitare nuk lejoheshin aktivitete për shfrytëzimin e burimeve natyrore. Në këndvështrimin e larmisë biologjike vargmalet tona kufitare kanë shërbyer si vendstrehim i shumë llojeve të faunës dhe florës Ballkanike. Duke qënë e pamundur të mbrohet i gjithë kufiri, si Brezit i Gjelbër i Shqipërisë shërben një rrjet zonash të mbrojtura natyrore ku bëjnë pjesë: i) në krahinën e veriut Liqeni i Shkodrës, Lugina e Valbonës, Lumi i Gashit, Vargmali Korab-Koritnik; ii) në krahinën qendrore Malet Shebenik-Jabllanicë; iii) në krahinën jugore rajoni Ohër-Prespë, Bredhi i Sotirës dhe zona e Butrintit në skajin më jugor.